



Prishtinë, 04.10.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1406_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2213_07_21** i dt. 26.07.2021;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 01.09.2021;

në seancën e mbajtur më datë **04.10.2021** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit S.S nga Komuna e Prishtinës si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2213_07_21, i datës 26.07.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE me datë 26.07.2021 ka marrë vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2213_07_21 me të cilin e ka refuzuar pjesërisht ankesën e konsumatorit S.S dhe e ka obliguar ndërmarrjen KESCO që t'i anulojë faturat e dt. 26.12.2018 dhe 25.02.2019, lidhur me kontestimin e faturës për periudhën shkurt 2019, për shkak të dyshimit për matje dhe faturim jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 43111792.

I pakënaqur me vendimin e DMK-së, konsumatori S.S, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Shtëpia është e pabanuar, dhe se fatura e kontestuar është shumë e lartë;
- KEK/KEDS kanë gabuar në faturimin e konsumatorit, andaj ka kërkuar rishqyrtim nga ZRrE.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 04.10.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRrE-së ka administruar provat si në vijim: Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit të dt. 29.11.2018, Procesverbalin e Inspektimit të dt. 29.01.2019, Ankesën e konsumatorit në KESCO të dt. 28.02.2019, Procesverbalin e inspektimit të dt. 13.03.2019, Përgjigjen e KESCO të dt. 18.04.2019, ankesën e konsumatorit të dt. 13.05.2019, vendimin e kontestuar, ankesën e konsumatorit të



dt.01.09.2021, Rrjedhën e Energjisë Elektrike, Transaksionet dhe Listat e leximit. Pas administrimit të të gjitha provave materiale veç e veç, Bordi ka konstatuar këtë gjendje faktike:

- Me datë 29.11.2018 konsumatorit i është vendosur njehsori i ri me gjendje të njehsorit TL=000000 kW dhe TU=000000 kWh, dhe nga ekipi i KEDS është konstatuar që njehsori i vjetër nuk merret, kurse njehsori i ri vendoset në shtyllë.
- Me datë 29.01.2019 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë inspektuar pikën matëse dhe në procesverbal kanë evidentuar se njehsori elektrik nuk është regjistruar me kohë në sistem, pasi që shifra e konsumatorit ka qenë e shkruar gabim.
- Me datë 25.02.2019 KESCO i dërgon konsumatorin faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën shkurt 2019 me shpenzim prej 1,351 kWh, ose e shprehur në vlerë financiare 69.26 EUR.
- Me datë 13.03.2019, pas ankesës së konsumatorit, punëtorët e autorizuar të KEDS-it e kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë evidentuar se njehsori elektrik nr. 43111792 është i vendosur në shtyllë, dhe se nuk kanë arritur që të bëjnë inspektimin e njehsorit, përfshirë këtu gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorë.

Bordi ka analizuar me kujdes dhe rrjedhën e energjisë elektrike, listat e leximit dhe procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik dhe konstaton se, përkundër faktit që njehsori i ri i konsumatorit, i vendosur me dt. 29.11.2018, i njëjti nuk është regjistruar deri në periudhën 02/2019, dhe se konsumatori ka vazhduar të faturohet pa matje me njehsorin nr. 67239080. Po ashtu, vërehet se, edhe përkundër faktit që njehsori është evidentuar në CCP në periudhën 02/2019 gjendja e shpenzimeve të faturuara më herët (periudha 12/2018 dhe 01/2019 si dhe fatura 0219245712DPR-35406) nuk është përmirësuar në CCP.

Andaj, duke pasur parasysh të gjeturat, Bordi konstaton se në njehsorin elektrik në periudhën 02/2019 në njehsorin elektrike nr. 43111792 është evidentuar shpenzim i energjisë elektrike prej TL=605 kWh dhe TU=747 kWh, pra shpenzimi ka ndodhur në atë njehsor elektrik. Lidhur me këtë ZRRE duke pasur parasysh faturimin e kWh të grumbulluar në faturën nr.02190DPR-35406 të datës 25.02.2019 ka bërë shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike - kWh të faturuara në faturën nr.02190DPR-35406 të datës 25.02.2019 për periudhën 12/2018 – 02/2019 dhe rezulton se konsumatorit nuk i takon korrigjim financiar, por që konsumatorit duhet t'i anulohen faturat nr.12180DPR-35406 të datës 26.12.2018 dhe nr.0219245712DPR-35406 të datës 25.02.2019.

Bazuar në të gjitha analizat e bëra konstatohet se KESCO ka nuk vepruar konform nenit 28 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univërsal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit, 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të*



pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese.” Andaj, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 04.10.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit S.S dhe
- Arkivit të ZRRE-së.